

Permbledhja JOTEKNIKE

Projekti:

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)

Me vendndodhje: Pasuarja nr. 131/18, Zona Kadastrale nr. 2183, Bashkia Vore

Zhvillues: "AL.BE" Shpk

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)

HYRJE

Hartimi I vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis hartohet me kërkesë të zhvilluesit me qëllim aplikimin për tu apsjur me Vendimin e VNMSë paraprake.

Kompania /Emri tregtar ; **“AL.BE” sh.p.k**

Nr. NIPTI; **L11612011P**

Adresa ; **Vorë**

Bashkia: **Vorë**

Për impiantin/instalimin: **“Menaxhimi i mbetjeve”**

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)

Kapaciteti i projektuar : **50Ton/ditë**

Tarifa e paguar në datë: **30000 leke, më datë / /2021**

Për kërkesë për leje mjedisi Tipi “B”

Numri i Punonjësve: **6 (Gjashte)**

Pronësia e tokës: **Me qera sipas Kontrate qeraje date 08.04.2021**

Emri dhe mbiemri i pronarit: **Feti EGRA. Pasuaria nr. 131/18, Zona Kadastrale nr. 2183, vol.7, faqe 237, Vorë. Siperfaqe totale truall 3725m²**

Pronësia e impiantit: **Behar NAZERAJ**



Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)

PËRSHKRIMI I INSTALIMIT "STACION TRANSFERIMI PËR MBETJE JO TË RREZIKSHME

Subjekti zhvillon veprimtarinë etij ekonomike në sferën e grumbullimit, seleksionimit dhe paketimit të mbetjeve plastikë dhe letër me qëllim tregëtimin në subjektet ricikluse brenda dhe jashtë vendit (eksport). Keto mbetje grumbullohen nga tregtare privat dhe janë mbetje që krijohen nga aktiviteti familjar dhe aktivitete ekonomike të ndryshme.

Këtë veprimtari subjekti e ushtron që në vitin 2013 në Vaqar, pranë "Shega Trans", Tiranë konform lejes së mjedisit Tipi C Nr. Serial PN-4250-11-2016. (nr.880 Prot. dt.15.11.2016 Nr. Identifikues 880.

Aktualisht subjekti kërkon zhvillimin e veprimtarisë në një vendndodhje të re në Vore në sipërfaqen/objektin e marre me qera. Organizimi i truallit të marrë në përdorim është në funksion të procedurës së kësaj veprimtare (teknologjisë), ka ambientet ndihmëse, ambienti i pranimit ku është vendosur peshorja; ambienti i seleksionimit (në sheshe të hapura); ambienti i presimit ku është vendosur një presë, për këtë shërben një tetojë e hapur me mbulim eternit. Ka rrethim mur blloku me infrastrukturë të rregullt si në aspektin e ujesjelles kanalizimeve ashtu dhe të furnizimit me energji elektrike. Zona është terren i sheshtë, bën pjesë në zonë jo të banuar, dhe është një ndër zonat për zhvillim industrial. Sheshi ka formën e një katërkëndëshi të rregull.

Pajisjet/makinerite që përdoren janë

- peshorja,
- presa,
- vinc pirun për levizjen e materialit.


Kapaciteti grumbullues leter, karton, plastike është **50 ton/ditë**.

Lëndët e para/mbetjet që grumbullohen janë:

- leter,
- karton,
- plastike (bidona plastike uji,
- pije freskuese etj).

Skema teknologjike e veprimtarisë "Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme "

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)



Lëndët ndihmëse : uje per larje sheshe, higjeno sanitar dhe energji elektrike

Konkretisht aktiviteti kryen keto procese:

Pranimi dhe peshimi I materialit te ardhur

Grumbullimi i mbetjeve leter, karton, plastike te llojeve te ndryshme dhe seleksionimi (ndarja e tyre)

Perpunimi I materialit leter qe nenkupton presimin ne prese dhe me pas duke e paketuar ne paleta per tu tregtuar/eksportuar ne subjekte qe realizojne riciklimin brenda dhe jashte vendit.

Peerpunimi I materialit plastic PET (bidona plastike uji, pije freskuese etj) duke e presuar dhe paketuar ne paleta I gatshem per tu tregtuar ose eksp[ortuar ne subjekte qe realizojne riciklimin brenda dhe jashte vendit.

Veprimtaria kryhet me nje turn, me nje nderrese 8 ore/dite me nje staf prej 6 punonjes.

Trualli në të cilin kompania do të zhvillojë këtë aktivitet, është një truall I ndërtuar, dhe ambjentet e jashtme janë të shtruara. Pra zhvillimi I kativitetit nuk prek bimësinë e zonës. Gjithahstu përreth objektit ndodhen aktivitet industriale dhe tregtare.

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)



Ky është sehsh industrial në të cilën është i ndërtuar godina e cila do të shërbejë si ambient shërbimi.



Vështrim i përgjithshëm mbi bimësinë e zonës:

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)

Mungesa e bimësisë në zonat fushore, shpjegohet me zhdukjen e bimësisë higrofitë nga veprimtaria ekonomike për sigurimin e tokave bujqësore.

1. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME

Raporti paraprak i vlerësimit të ndikimit në mjedis u hartua në përputhje me ligjin Nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar.

Struktura e këtij raporti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor të cilat janë përcaktuar në VKM 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.

Vlerësimi i ndikimeve negative në mjedis kryhet në bazë të parimeve për mbrojtjen e mjedisit, siç janë;

- Parimi për një zhvillim të qëndrueshëm;
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave;
- Parimi për ruajtjen e burimeve natyrore
- Parimi për zëvendësimin apo kompensimin;
- Parimi ndotësi paguan
- Parimi i së drejtës për informim dhe pjesëmarrjes së publikut
- Etj

Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 10431, datë “për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar), Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me ndikime në mjedis që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për t’u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje letër, plastike)

që të kuptohet natyra e këtyre ndikimeve, forma e shfaqjes së tyre dhe më analitikiisht ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të parinovueshme.

Shumë prej ndikimeve negative mjedisore mund të minimizohen përmes një planifikimi të kujdesshëm mjedisor dhe aplikimit të teknikave dhe teknologjisë së parandalimit të ndotjeve.

Identifikimi i ndikimeve negative në mjedis do të vlerësohet për komponentët e mëposhtëm;

- Ndikimet në tokë
- Ndikimet në ujë
- Ndikimet në ajër
- Ndikimet nga zhurmat
- Ndikimet në pjesëz
- Ndikime në florë dhe faunë
- Ndikimet nga zhurmat
- Ndikime sociale

Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve në mjedis do të kryhet duke u bazuar në karakteristikat dhe proceset teknologjike që zhvillohet në këto aktivitete.

Aktivitetet kryesore janë:

- Ardhja e lëndës së parë (letër, karton, plastikë)
- Peshim dhe Seleksionim
- Presimi
- Paketimi

1.1 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative

1.1.1 Ndikimet në tokë

Zhvillimi i projektit i referohet zhvillimit të aktivitetit për grumbullimin, seleksionimin dhe paketimin e mbetjeve plastike dhe letër me qëllim tregëtimin në subjektet ricikluse brenda dhe jashtë vendit. Sic shikohet edhe në planin e mëposhtëm sheshi ku do të zhvillohet veprimtaria është i shtruar me beton, godina dhe kapanoni i shërbimit janë ekzistues.

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)



Referuar procesit të punës që zhvillohet në këtë objekt si dhe referuar gjëndjes së objektit vlerësojme se zhvillimi i veprimtarisë nuk do të shkaktojë kontaminim të tokës. Gjithashtu zhvillimi i aktivitetit nuk shkakton ndikime në rreshkitje, erosion apo përdorimin e tokës.

1.1.2 Ndikimet në ujë

Në këtë aktivitet uji do të përdoret vetëm për të krye pastrimin e sheshit, dhe për nevoja higjienosanitare. Ky uji do të shkarkohet në rrjetin e kanalizimeve për tu menaxhuar si mbetje urbane e parrezikshme. Zhvillimi i aktivitetit nuk ndikon në cilësinë e ujrave të zonës, nuk ndikon në rrjetin e furnizimit me uji dhe kanalizimet. Uji do të matet nëpërmjet matësit dhe do të paguhet sipas kontratës së lidhur me Ujësjellës Kanalizime.

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)

1.1.3 Ndikimet në ajër

Ndikimet të cilat do të shkaktohen në ajër si rezultat i zhvillimit të aktivitetit do të jenë të papërfillshme, për faktin se nuk do të aplikohen punime ndërtimi, dhe proceset teknologjike të seleksionimit, presimit dhe paketimit të mbetjeve nuk shkaktojnë emetime në ajër.

Si burim kryesor i ndikimeve në ajër janë mjetet e ngarkim shkrkimit të mbetjeve. Ky ndikim është i parëndësishëm për zonën pasi objekti ndodhet në kufi me rrugën dhe e rrethuar me aktivitet të tjera tregtare.



Figura 1: Zona e projektit dhe rrugët kryesore

1.1.4 Ndikimet në peisazh

Zhvillimi i projektit nuk vlerësohet të shkaktojë ndryshime në peisazh, për faktin se objekti është ekzistues, dhe mjediset e shërbimit janë të rrethuara.

1.1.5 Ndikimet në florë dhe faunë

Zona ku do të zhvillohet projekti nuk bën pjesë në ndonjë kategori të zonave të mbrojtura dhe në afërsi të saj nuk ka zona me rëndësi kombëtare ose ndërkombëtare. Gjithashtu trualli ku do të zhvillohet kjo veprimtari është i shtruar me beton, objektet janë ekzistuese. Pra në këto kushte zhvillimi i këtij aktiviteti nuk shkakton ndikime në florën dhe faunën e zonës.

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)

1.1.6 Ndikimet nga zhurmat

Objekti ndodhet në kufi me rrugën dytësore, dhe mjaft pranë autostradës Tiranë – Durrës, përreth aktivitetit gjithashtu operojnë aktivitete të tjera industriale dhe tregtare, kjo do të thotë se kjo është një zonë me prani të vazhduar të zhurmave. Në hartëne meposhtëme tregohet urbanizimi i zonës përreth objektit.



1.1.7 Ndikimet sociale

Projekti nuk vlerësohet të shkaktojë ndikime negative sociale, ekonomike dhe shëndetësore. Përkundrazi ky aktivitet vlerësohet të ketë impakte pozitive në punësim.

1.1.8 Gjenerimi i mbetjeve

Nga zhvillimi i aktivitetit do të krijohen mbetje të ngurta në sasira të pakonsiderueshme, që janë mbetje urbane rreth 1kg/ditë. Këto mbetje hidhen në pikat e caktuara nga organet e pushtetit vendor, kazanët, brenda ditës për të mos ambientin.

Shkarkime të ujerave lares: sasia 40m³/muaj. Shkarkimi bëhet në rrjetin e kanalizimeve.

Aktiviteti kontribuon në menaxhimin e mbetjeve.

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)

2. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm e prespektiv të mjedisit në planin e organizimit të punës, shoqëria ndërtuese të marrë të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndikimet negative në mjedisin përreth zonës.

Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis janë një pjesë e rëndësishme e raportin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në këtë kapitull do të trajtojmë masat që duhet të zbatohet zhvilluesi për zbutjen apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis, si; masat e mundshme për shmangien e ndikimeve në tokë, në peisazh, në ujë dhe në ajër. Këto masa synojnë reduktimin, shmangien dhe menaxhimin e ndikimeve negative.

2.1 Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në tokë

Nga zhvillimi normal i aktivitetit nuk do vlerësohen të shkaktohen ndikime në tokë. Pavarësisht kësaj subjekti zhvillues i këtij aktiviteti ti kushtojë rëndësi të vecantë mirmbajtjes zonës ku do të kryhet grumbullimi, seleksionii dhe kompresimi i mbetjeve. Gjithashtu subjekti të mirmbajë sistemin që mbledh ujrat e pastrimit dhe ujrat e shiut për tu siguruar që ato derdhen në sistemin e kanalizimeve, për të shmangur në cdo rast shkakrimin e tyre në mjedis.

2.2 Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në ujë

Ndërtimi i objektit nuk ka ndikim në ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë. Si rrjedhojë nuk përcaktohen masa konkrete.

2.3 Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në ajër

Nga zhvillimi i veprimtaris ë në tërësi pritet të ketë ndikime në ajër si rezultat e aktivitetit të mjetve të transportit të mbetjeve, për të mbajtur këtë ndikim në vlera minimale subjekti të kruejë pastrimin e zonës së punës, të mirmbajë mjetet e punës.

Monitorimi i mjedisit është i rëndësishëm pasi do të kontribuojë në evidentimin e përqëndrimit të pluhurave në ajër dhe nëse masat e aplikuara janë eficiente apo ka nevojë për masa shtesë. Normat e përqëndrimit të ndikimeve në ajër duhet të jenë brënda normave të përcaktuara në VKM nr. 803 që i referohet cilësisë së ajrit në zona urbane.

2.4 Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në peisazh

Projekti nuk sjell ndryshime në peisazh për faktin se facilitet janë të ndërtuara.

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (mbetje leter, plastike)

2.5 Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve nga zhurmat

Për të reduktuar këtë ndikim kompania do të marrë një sërë masash si:

- ✓ Të punohet në oraret zyrtare;
- ✓ Të respektohen oraret e qetësisë publike;
- ✓ Automjete e transportit të lëvizin me shpejtësi të kufizuar.
- ✓ Kompania duhet të sigurojë që niveli i zhurmave të mos kalojë limitet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8 datë 27.11.2007 “për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.
- ✓ Në çdo rast niveli i zhurmave nuk duhet të kalojë mbi normat e përcaktuara në legjislacionin shqiptar.